



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ


REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2018:009821

Datë: 27.09.2018

Numri i dokumentit: 00135154

VENIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC



P.nr. 3044/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari individual Adem Shabani, me pjesëmarrjen Zyrtaren Ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II.nr.805-7/16 të datës 30.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit më datën 27.09.2-018 të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpall këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Ferizaj, i lindur më [REDACTED] në Gjilan, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së varfër ekonomike, i pa punë me numër personal [REDACTED] mbrohet në liri,-.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 12.02.2016, rreth orës 18.45, tek Stacioni i Autobusëve në Feriza, pas një mosmarrëveshje momentale me të dëmtuarin [REDACTED] fillimisht e thërret i pandehuri të dëmtuarin që të bisedojnë e pyet pse po më shikon, aty afrohen edhe persona të tjerë dhe

fillon konflikti fizik ku i pandehuri me një thikë, mjet ky i përshtatshëm për shkarkimin e lëndimit të rëndë trupor, e godet të dëmtuarin dy herë në të dy këmbët, në të cilin rast i dëmtuari pëson, lëndime të lehta trupore, këtë të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 23.09.2017,-

-Me të këtë kreu veprën penale për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 21, 41,42, 43,45, 48 dhe 73 të KPK-së, dhe nen 365 të KPPK-së,

GJYKON

Të akuzuarin [REDAKTUAR] me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve.

Në mbështetje të nenit 48 par.1 të KPK-së, dënimi i shqiptuar me burgim me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet:

ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME prej 140 (njëqind e katër dhjetë) orëve, të cilën do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Punën në dobi të përgjithshme duhet ta kryej brenda afatit prej tre muajve.

Konform nenit 48 par. 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditët, javët që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikëqyrë punën në dobi të përgjithshme.

Ndërsa në mbështetje të nenit 48 par.4 të KPK-së, nëse pas kalimit të kohës së caktuar i pandehuri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, gjykata do të urdhëroj dënimin me burgim, ku një ditë burgim do të urdhërohet për çdo (8) tetë orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Të dëmtuarin [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], Komuna Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i pandehuri të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko- ligjore shumën prej 20 Euro, dhe paushallin gjyqësor në shumë prej nga 20 (njëzetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

I shqiptohet taksa në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimin. në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.805-7/16 të dtës 30.11.2017, ka ngarkuar të akuzuarin akuzuarit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.27.09.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani dhe i akuzuari [REDAKTUAR]

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë respektuar, e më pas Prokurori i Shtetit ka lexuar aktakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari [REDAKTUAR] ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar shpreh keqardhje për veprën penale që e ka kryer, kërkim falje të dëmtuarit edhe pse nuk është prezent në seancën gjyqësore por në tersi mbështetë dëkuarën që e ka dhen në polici por data nuk i kujtohet mirëpo ka shkua te Stacioni i autobusëve për me shkuar në shtëpi diku ishte ora 20:00 ku aty ishte vetë dhe një person e ka shikuar dhe ke shtyrë të dyshon aji i ka thënë jo s'po të njoh i ka thënë mendova se je diçka i dyshimtë në mua, dhe për një moment është larguar nga aty por pa pritur erdhën disa persona

ku ky i ka thënë që të largohen nga aty se mundë të dyshon ndokush se ka diçka dhe dikush mundë të thërrasë policinë por njëri nga ata u përgjigj rreptë dhe i ka thënë ti nuk mundesh me ma ndal hapin e as gojën dhe në atë moment u bë nervoz dhe deshti ta godas me grusht por nuk e godita dhe një tjetër më goditi me grusht në fytyrë dhe aty fillova me u rrah me atë djalin të panjohur por atu edhe tre personat tjerë e kanë goditur dhe ky ka ra në tok nga goditjet e marruara dhe ky për tu mbrojtur ka nxjerrë një brisk nga jaka dhe nuk e di se kë e ka goditur në këmbë dhe dikush ka bërtitur policia, polici dhe ka ikur ma vonë ka kuptuar se lëndime ka marrë personi që tani është në cilësi të dëmtuarit, ku më vonë është takuar me te dhe është pajtuar, tani për këtë rast nuk kanë kurrfarë problemi. Në vazhdim e njofton gjykatën se është njoftuar nga familjarët se edhe më parë për këtë rast është ftuar nga gjykata por nuk ka mundur që paraqitur pasi ka qenë në vuajtje të dënimit për një veprë tjetër penale, ka kërkuar nga gjykata që nëse e shpallë fajtor lidhur me shqiptimin e dënimit të merre për bazë theksimet e cekura më lartë.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit dhe pranimi mbështetet edhe me provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njëjtin ta pranoj si të tillë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së është i bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale në deklaratën e vetë të pandehurit dhen në polici me datën 17.05.2016, deklaratën e të dëmtuarit dhënë me datën 10.03.2016 ,dhe në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. [REDAKTUAR] lidhur me lëndimet e të dëmtuarit [REDAKTUAR]

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupore nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit nenit 73 dhe 74 të KPPK-së, si

rrethana lehtësuese gjykata mori pendimin për veprën , kërkim falje të dëmtuarit për lëndimet që i ka shkaktuar, gjendjen e varfër të pandehurit, i pa punë, premtimin se më nuk do të përsëris vepra të tilla. Në bazë të këtyre rrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, e dënimi me burgim me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet: me punë në dobi të përgjithshme prej 140 (njëqind e katër dhjet orë) orëve, të cilën do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit, duke qenë i bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri dhe personalitetin e të pandehurit konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së, të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të krimit Nr.05/L-036.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.3044/17 me datë 27.09.2018

Zyrtarja Ligjore

Kadishe Shabani



Gjyqtari

Kadishe Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.